

Të dhëna bazike të lëndës	
Universiteti	Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj
Njësia akademike:	Fakulteti i Inxhinierisë dhe Informatikës
Programi:	Inxhinieri Industriale me Informatikë
Titulli i lëndës:	Menaxhimi i kostos
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	III, Semestri VI
Numri i orëve në javë:	3
Vlera në kredi – ECTS:	4
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	
Detajet kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës:	Lënda Analiza e kostos dhe financave përfshin informimin e duhur rreth konceptit të menaxhimit, analizimit dhe kalkulimit të kostove. Definicionin rreth zbërthimit të kostove, rolin dhe rendësin e tyre në menaxhimin industrial. Analiza rreth kalkulimit dhe identifikimit të kostos apo shpenzimeve në proces të prodhimit si nevojë e domosdoshme për vendimmarrjen menaxheriale. Elaborati i strukturës dhe klasifikimi i kostove, përmes shembujve dhe detyrave për kalkulimin e kostove do të jenë informacion shtesë, praktik për njohurit e fituara. Kategoritë e kostove për produktin, Identifikimi, analiza dhe kalkulimi i kostove të prodhuesve dhe industrive tjera. Analiza dhe kalkulimi i kostove të prodhimit, marketingut, shërbimeve, administratës dhe stafit në ndërmarrje. Programi i kësaj lënde do të njoftojë edhe me kostot jo-prodhuese dhe ndikimi i tyre në rezultatin final financiar të ndërmarrjes.
Qëllimet e lëndës:	Njohurit e fituara përmes kësaj lënde, kanë për qëllim që studentët të përfitojnë dijen mbi konceptin e menaxhimit dhe analizimit të kostove dhe kalkulimin e tyre në ndërmarrje. Do të njoftohen me analizën e kostove, strukturën dhe klasifikimin e tyre, kostot direkte dhe indirekte në proces të prodhimit dhe ndikimi i tyre në rezultatin financiar final për marrjen e vendimeve afariste në ndërmarrje. Përmes shembujve dhe detyrave praktike do të arrijnë përlllogaritjen të mënyrës së kalkulimit të kostove në industrinë e prodhimit dhe shërbimeve. Po ashtu do të njoftohen me analizën e kostove marginale, mesatare, periodike dhe si ndikojnë ato në afarizmin dhe vendimet menaxheriale.
Rezultatet e pritura të mësimnxënies:	- Pas përfundimit të lëndës, studenti duhet të jetë në gjendje të arrijë: - Të ketë njohuri më të avancuara për kostot dhe analizimin e tyre gjatë aktivitetit të punës në ndërmarrje,

	• Te përllogaritë kostot marginale, mesatare, periodike dhe si ndikojnë kostot ne afarizmin e ndërmarrjes, • Analizimi dhe kalkulimi rreth të të gjitha llojeve të kostove ne ndërmarrje, • Te kalkulimit te kostove marginale, mesatare, periodike dhe si ndikojnë kostot ne afarizmin e ndërmarrjes, • kalkuluar dhe identifikuar kostot direkte dhe indirekte ne ndërmarrje, • Te mbikëqyrë analizën e nivelit te kostove, • Shkathtësi për te zgjedh problemet me shpenzime te tepërta te ndërmarrjes, • Kompetent dhe pjesëmarrës aktiv ne ekipin mbikëqyrës te shpenzimeve ne ndërmarrje, • Për te kryer një analizë për nivelin e pjesëmarrjes se kostove ne produktin e plasuar ne treg nga ndërmarrja, • Te udhëheq me ekipin mbikëqyrës për kostot ne ndërmarrjes,		
Parakushtet	N/A		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Aktiviteti	Aktiviteti	Aktiviteti
Mësim teorik dhe praktik	3	15	45
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet			
Ushtrime në teren			
Kollokviume, seminare deh projektet	3	2	6
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	10	20
Përgatitja përfundimtare për provim	7	2	14
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz dhe provim final)			
Projektet dhe prezantimet	3	5	15
Totali			100
Metodologjia e mësimdhënies:			
	Ligjërata interaktive me studente lidhur me temat e ligjëruara, orientimi ne shtjellimin e materialit duke mare raste studimi te cilat do te diskutohen ne grup, mësimi duke u bazuar ne një problem te paraqitur, prezantimi i studenteve për Raste studimi, Punime seminarik-shkencore, Ese apo Hulumtim, si dhe bashkëpunimi aktiv ne ekip i studenteve		
Metodat e vlerësimit:			
	Studenti mund të zgjedhë për t’u vlerësuar njërën nga dy format e vlerësimit, dhënë më poshtë:		

1. Forma 1: Vlerësimi me kollokviume dhe projekt
2. Forma 2: Vlerësimi me provimin përfundimtar.

Forma 1:

Në formën e parë të vlerësimit” Vlerësimi me kollokviume dhe projekt “studenti vlerësohet në katër aktivitete që realizohen gjatë ligjëratave:

1. Kollokvium 1 (30%), vlerësim individual
2. Kollokvium 2 (30%), vlerësim individual
3. Aktiviteti në klasë (10%), vlerësim individual
4. Projekti (30%), vlerësim grupor.

Sqarim shtese:

Nëse studenti në secilin aktivitet të mësipërm arrin pikët maksimale, atëherë ai do të vlerësohet me 100 pikë.

Studentët të cilët e kalojnë provimin sipas formës 1 të vlerësimit, lirohen nga obligimi për t’iu nënshtruar provimit final. Vetëm nëse studenti nuk është i kënaqur me vlerësimin e arritur sipas formës 1, atëherë ai mund t’i nënshtrohet provimit final për të përfutur vlerësim më të lartë.

Forma 2:

Në formën e dytë të vlerësimit” Vlerësimi me provimin përfundimtar”, studenti do t’i nënshtrohet provimit i cili mbahet pas përfundimit të ligjëratave të lëndës, dhe organizohet në afatet e provimeve, të përcaktuar nga senati i Universitetit.

Përmes provimit final studenti maksimalisht mund të arrijë 70% të pikëve nga totali prej 100 pikë.

Pjesa tjetër e pikëve prej 30% duhet të plotësohet nga puna grupore në Projekt, aktivitet i realizuar gjatë ligjëratave.

Në Kollokvium 1, Kollokvium 2 dhe provim përfundimtar vlerësimi i studenteve do të bëhet përmes një formulari vlerësimi, i cili duhet të plotësohet në mënyrë individuale nga studenti. Formulari i vlerësimit do të përmbajë pyetje objektive dhe subjektive përmes të cilave do të vlerësohen rezultatet e të nxënës të studentit:

- *Pyetjet objektive do të jenë të llojit: (1) Pyetje me zgjedhje të shumëfishta, (2) E Sakte/ Jo e Sakte, (3) Plotësim dhe (4) Kompozim/ Përputhje; pyetje që do të shfrytëzohen për të vlerësuar aftësitë e studentit për të ri- kujtuar dhe njohur konceptet dhe materialin e lëndës.*

- *Pyetjet subjektive do të jenë të llojit Ese/detyrë me shkrim që do të shfrytëzohen për të vlerësuar të kuptuarit dhe aftësitë e studentit për të zbatuar njohuritë e fituara në analizë, sintezë dhe*

	<i>vlerësim të problemit, nga përgjigjet e hartuara nga studenti ndaj pyetjes së parashtruar.</i> <i>Aktiviteti në klasë-nënkupton angazhimin e studentit në trajtim të çështjeve të diskutuara ne klase, gjate ligjëratave.</i> <i>Projekti (30%), vlerësim grupor: është aktivitet në të cilin studentet zbatojnë në një projekt konkret njohuritë e fituara. Realizohet në grup prej 2 ose 3 studenteve te cilët kanë për obligim ta realizojnë aktivitetin, dokumentojnë edhe prezantojnë para profesorit të lëndës.</i> <i>Për formën e realizmit dhe dokumentimit te aktivitetit të gjithë anëtarët e grupit do të vlerësohen me pikë të njëjtë(20%), kurse vlerësimi i aftësive prezantuese të aktivitetit është individual dhe përfshinë 10%.</i> <i>Vlerësimi:</i> <i>91-100 pikë – vlerësohet me notë 10 (dhjetë)</i> <i>81-90 pikë – vlerësohet me notë 9 (nëntë)</i> <i>71-80 pikë – vlerësohet me notë 8 (tetë)</i> <i>61-70 pikë – vlerësohet me notë 7 (shtatë)</i> <i>51-60 pikë – vlerësohet me notë 6 (gjashtë)</i> <i>0-50 pikë – Studenti ri-përsëritë në provim.</i>
Raporti i teorisë dhe praktikës:	<i>70% Teori dhe detyra</i> <i>20% Angazhim i studentit gjatë Ligjëratave zgjidhje analitike te detyrave dhe problemeve te shtruara</i> <i>10% Praktik duke inkorporuar punimin analitik te studentit i cili mund te jete: Raste studimi, Punim seminarik-shkencor, Ese apo Projekt hulumtues,</i>
Literatura	
Literatura bazë:	<i>1. Skender Ahmeti Prof.Dr– “Kontabiliteti i Kostos” – Prishtinë 2018,</i>
Literatura shtesë:	<i>1. Skender Ahmeti Prof.Dr– “Kontabiliteti i Menaxhmentit” – Prishtinë 2018</i> <i>2. Horngren, Datar, Rajan “Cost Accounting”, Ed.15, USA, 2015</i>
Plani i dizajnuar i mësimit	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	<i>Prezantimi – njoftimi i studenteve me syllabusin e lëndës, Përshkrimi (prezantimi) i lëndës</i>
Java e dytë:	<i>Kontabiliteti i kostos në mjedisin biznesor</i>
Java e tretë:	<i>Konceptet bazike mbi kostot. Rrjedha e kostove të prodhimit</i>
Java e katërt:	<i>Kontabiliteti për materialin. JIT (Just in time). Llogaritja e OEQ (Economic Order Quantity)</i>
Java e pestë:	<i>Kontabiliteti për punën. Kontrolli i kostove të punës</i>

Java e gjashtë:	<i>Kontabiliteti për kostot indirekte të prodhimit. Metoda e kostove të punës direkte. Metoda e orëve të punës direkte. Metoda e orëve të makinës</i>
Java e shtatë:	<i>Testi i parë</i>
Java e tetë:	<i>Alokimi i kostove të departamenteve mbështetëse Alokimi i kostove të departamenteve mbështetëse tek departamentet prodhuese</i>
Java e nëntë:	<i>Alokimi i kostove në departamentet shërbyese dhe prodhuese. Metoda direkte. Metoda e shkallëzuar. Metoda e ndërsjellë</i>
Java e dhjetë:	<i>Alokimi i kostove tek departamentet shërbyese</i>
Java e njëmbëdhjetë:	<i>Alokimi i kostove: Produktet e lidhura dhe nënproduktet</i>
Java e dymbëdhjetë:	<i>Jorelevanca e kostove të lidhur për vendimmarrje</i>
Java e trembëdhjetë:	<i>Njësitë me defekte, njësitë e ripunuara dhe skrapit Kosto e proceseve dhe njësitë me defekte</i>
Java e katërbëdhjetë:	<i>Njësitë me defekte, njësitë e ripunuara dhe skrapit Kostot për porosinë dhe njësitë me defekte</i>
Java e pesëmbëdhjetë:	<i>Testi i dytë</i>
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes	
<i>Studenti është i obliguar t'i vijojë ligjëratat më rregull dhe të ketë sjellje korrekte ndaj kolegëve dhe stafit të Universitetit, mbajtja e qetësisë dhe angazhimi interaktiv gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve është e obligueshme.</i>	